

**KOMBET E
BASHKUARA**



Tribunali Ndërkombëtar për Ndjekjen
Penale të Personave Përgjegjës për
Shkelje të Rënda të së Drejtës
Humanitare Ndërkombëtare të Kryera
në Territorin e ish-Jugosllavisë prej
Vitet 1991

Lënda Nr. IT-04-84-A

Data: 4 mars 2010

Origjinali: anglisht

NË DHOMËN E APELIT

Para: Gjykatësit Patrick Robinson, Kryegjykatës
Gjykatësit Fausto Pocar
Gjykatësit Liu Daqun,
Gjykatëses Andrésia Vaz
Gjykatësit Theodor Meron

Sekretar: Z. John Hocking

Urdhër i datës: 4 mars 2010

PROKURORI

kundër

**RAMUSH HARADINAJT
IDRIZ BALAJT
LAHI BRAHIMAJT**

PUBLIK

**URDHËR PARALAJMËRUES NDAJ LAHI BRAHIMAJT
PËR PËRMBUSHJEN E KUSHTEVE TË LIRIMIT TË TIJ TË PËRKOSSHËM**

Zyrës së Prokurorit:

Z. Peter Kremer

Avokatëve të Mbrojtjes:

Z. Ben Emmerson QC dhe Z. Rodney Dixon për Ramush Haradinajn
Z. Gregor Guy-Smith dhe Zj. Collen Rohan për Idriz Balajn
Z. Richard Harvey dhe Z. Paul Troop për Lahi Brahimajn

DHOMA E APELIT e Tribunalit Penal Ndërkombëtar për Ndjekjen Penale të Personave Përgjegjës për Shkelje të Rënda të Së Drejtës Humanitare Ndërkombëtare të Kryera në Territorin e ish-Jugosllavisë që prej vitit 1991 (përkatësisht “Dhoma e Apelit” dhe “Tribunali Ndërkombëtar”).

DUKE MARRË SHËNIM se më 3 prill 2008, Dhoma Gjyqësore I shpalli Brahimajn fajtor për torturim dhe trajtim mizor si shkelje të ligjeve ose zakoneve të luftës, bazuar në Nenin 3 të Statutit të Tribunalit dhe e dënoi me gjashtë vjet burgim, duke i llogaritur edhe kohën që kishte kaluar në paraburgim në përputhje me paragrafin C të Rregullës 101 të Rregullores së Procedurës dhe Provave të Tribunalit (“Rregullorja”).¹

DUKE MARRË SHËNIM se aktualisht Dhoma e Apelit ka marrë apelimet kundër Aktgjyqimit të Dhomës Gjyqësore dorëzuar prej Brahimajt dhe Prokurorisë.²

DUKE MARRË SHËNIM se më 25 maj 2009, Dhoma e Apelit miratoi lirim të përkohshëm për Brahimajn bazuar në paragrafin I të Rregullës 65 të Rregullores, ndër të tjera me këto kushte:

Autoritetet e Misionit për Kosovën-EULEX ta udhëzojnë Brahimajn që gjatë periudhës së lirim të tij të përkohshëm, t’u përmbahet këtyre kushteve:

[...]

t’u përmbahet përpikmërisht udhëzimeve të autoriteteve të Misionit për Kosovën-EULEX që janë të nevojshme për t’u mundësuar atyre përmbushjen e detyrimeve të tyre sipas këtij Vendimi dhe garancive të tyre;

[...]

Autoritetet e Misionit për Kosovën-EULEX të garantojnë që:

Brahimaj të paraqitet çdo javë te autoritetet e Misionit për Kosovën-EULEX në vendbanimin e tij;³

DUKE MARRË PARASYSH se në raportin e përjavshëm të Misionit për Kosovën, EULEX pohohet se Brahimaj nuk u paraqit në një takim të planifikuar në banesën e tij;⁴

¹ *Prokurori k. Ramush Haradinajt dhe të tjerëve.*, Lënda Nr.IT-04-84-T, Aktgjykim, 3 prill 2008, para 504-505.

² Njoftim për Apel i Prokurorisë, 2 maj 2008; Njoftim për Apel në Emër të të Akuzuarit të Tretë Lahi Brahimaj, 5 maj 2008; Dosja e Apelit të Prokurorisë, 17 korrik 2008 (publik dhe i redaktuar); Dosje e Apelit në emër të Lahi Brahimajt, 21 korrik 2008, Bashkim me Përgjigjen e Ramush Haradinajt ndaj Dosjes së Apelit të Prokurorisë, 25 gusht 2008; Përgjigje e Prokurorisë ndaj Dosjes së Apelit në emër të Lahi Brahimajt, 1 shtator 2008 (publik dhe i redaktuar); Dosje e Kundërpërgjigjes së Lahi Brahimajt 15 shtator 2008.

³ *Prokurori k. Ramush Haradinajt dhe të tjerëve.*, Lënda Nr.IT-04-84-A, Vendim në lidhje me Kërkesën e Lahi Brahimajt për Lirim të Përkohshëm, 27 maj 2009, paragrafi 18(e)(v), (f)(ii).

⁴ Raport i Përjavshëm i EULEX-it në lidhje me Lirimin e Përkohshëm të Lahi Brahimajt, 19 shkurt 2010 (kondidencial).

BAZUAR në Rregullat 54, 65(I), dhe 107 të Rregullores, Dhoma e Apelit:

NËPËRMJET KËTIJ DOKUMENTI RIKUJTON Lahi Brahimajn se ai është nën detyrimin e urdhrin gjyqësor të Dhomës së Apelit për t'iu përmbajtur përpikmërisht kushteve të lirimimit të tij të përkohshëm; dhe

PARALAJMËRON Lahi Brahimajn se lirimi i tij i përkohshëm do të përfundojë në rast se ai nuk respekton udhëzimet e autoriteteve të Misonit për Kosovën, EULEX, të nevojshme për t'u mundësuar atyre përmbushjen e detyrimeve në lidhje me lirimin e tij të përkohshëm.

Përpiluar në anglisht dhe frëngjisht; teksti në anglisht ka përparësi.

/nënshkruar në origjinal/
Gjykatës Patrick Robinson
Kryegjykatës

Sot, më datën 4 mars 2010.
Në Hagë
Holandë

[Vula e Tribunalit Ndërkombëtar]